

Vetëdeklaratë nga punëmarrësi

Statusi: 16 shkurt 2021

Në kuadër të pandemisë aktuale të koronavirusit unë deklaroj se jam informuar mbi situatën aktuale dhe masat mbrojtëse të zbatueshme dhe se do të respektoj veçanërisht në mënyrë rigoroze pikat e mëposhtme për mbrojtjen e shëndetit:

- Unë i kam marrë, i kam lexuar dhe kuptuar informacionet për sjelljen e duhur dhe marrjen e masave mbrojtëse përkatëse, të cilat unë jam duke i zbatuar.
- Unë jam në dijeni të koronavirusit dhe/ose kam vizituar faqen e internetit të Zyrës Federale të Shëndetit Publik [*Bundesamt für Gesundheit*] <https://bag-coronavirus.ch> ku edhe jam i informuar.
- Gjatë punës në ekipin tim të punës, unë do t'i kushtoj vëmendje sjelljes së duhur të të gjithëve dhe do tërheq vëmendjen në raste pakujdesie, nëse është e nevojshme.
- Askush nga rrethi im i ngushtë nuk ka qenë apo ka udhëtuar në vende të rrezikuara, jashtë Zvicrës në javët e fundit. Në rast të kundërt, unë do të përpiqem ta shmang kontaktin e drejtpërdrejtë me këta persona sa të jetë e mundur, si dhe do të respektojë në mënyrë të veçantë rekomandimet e BAG-së.
- Sipas mundësisë, unë do t'i shmang udhëtimet, për sa kohë këto janë të lejuara, në vendet e rrezikuara, dhe jam i vetëdijshëm për karantinimin e detyruar.
- Nëse një udhëtim është absolutisht i nevojshëm, unë do të kryej testin e detyrueshëm të koronavirusit për personat që kthehen para ri-hyrjes dhe do të plotësoj formularin e detyrueshëm të hyrjes nga autoritetet zvicerane: <https://swissplf.admin.ch/formular>
- Unë jam i vetëdijshëm se për periudhën e karantinimit pas kthimit nga udhëtimi në një vend të rrezikuar, në rrethana të caktuara, NUK kam të drejtë page apo të drejtën e përfitimeve për zëvendësimin e të ardhurave. Për të shmangur humbjen e pagave, unë do të kthehem më herët në Zvicër që jem në dispozicion të kompanisë në kohën e duhur për të filluar punën.
- Në rast se do të kem simptoma sëmundjeje, si ethe, kollë etj., do të qëndroj menjëherë në shtëpi dhe do të vë në dijeni eprorin tim për këtë gjë.
- Në rast se në ambientin tim të punës, do më bien në sy simptoma të sëmundjes te personat e tjerë, do ta raportoj këtë menjëherë tek eprori apo te menaxheri im.

Mbiemri, emri i punëmarrësit: _____

Lexuar dhe kuptuar, më (data): _____

Nënshkrimi i punëmarrësit: _____